

V E N D I M
Nr.544, datë 14.11.1994

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR BIRËSIMET

Me propozimin e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpenzimet që bëhen për verifikimin dhe përgatitjen e dosjeve me dokumentet përkatëse të përcaktuara në ligj për çdo të mitur që birësohet, përballohen nga personat birësues shtetas shqiptarë a të huaj, sipas tarifave dhe taksave të caktuara me dispozitat në fuqi. Pagesa e shpenzimeve bëhet pasi merret vendimi për birësim nga gjykata.

2. Shpenzimet për shërbimet që kryhen nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve për birësimin e të miturve shqiptarë nga shtetasit e huaj, përballohen nga organizatat private a shtetërore të huaja të birësimeve me të cilat Komiteti bashkëpunon, në masën që përcaktohet në marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Komitetit dhe këtyre organizatave.

3. Për birësimin e të miturve nga shtetas shqiptarë, shpenzimet për shërbimet që kryhen nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, përballohen nga këta shtetas sipas tarifave të caktuara nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Birësimeve.

4. Të ardhurat, sipas pikave 1,2 dhe 3 të këtij vendimi, derdhen në bankë në llogarinë e Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

Këto të ardhura trajtohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.478, datë 7.11.1992 “Për krijimin, evidencimin dhe administrimin e të ardhurave që realizojnë institucionet buxhetore nga shërbimet që ata u ofrojnë të tretëve”.

5. Anëtarët e Komitetit Shqiptar të Birësimeve marrin një shpërblim mbi pagë në masën deri në 1000 (një mijë) lekë në muaj për pjesëmarrjen në mbledhje. Dhënia e shpërblimit vendoset nga Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve në përputhje me veprimtarinë dhe kontributin e çdo anëtari.

Fondet e shpërblimit, përjashtimisht vetëm për vitin 1994, përballohen nga buxheti i miratuar për aparatet e Këshillit të Ministrave.

6. Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi caktohen nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi